

Shoqëria: Fat & Proalb sh.p.k
Selia: Ballsh, Fier, Albania
NUI: M07523801F

**VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

Nr. 03 datë 12.10.2021

Sot më datë 12.10.2021 në selinë e shoqërisë u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e thirrur nga administratori i shoqërisë z. Ervis Kau për marrjen e vendimit për miratimin e kalimit nëpërmjet shitjes, të 100% të kuotës së ortakut Erjon Kasmi që përfaqëson 50% të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, në favor të z. Redinal Muskaj.

Në mbledhjen e sotme, Antarët e pranishëm janë:

Struktura e ortakëve të shoqërisë:

Ervis Kau me 50% të kuotës së shoqërisë dhe Erjon Kasmi me 50% të kuotës së shoqërisë.

Anëtarë të pranishëm janë: Ervis Kau dhe Erjon Kasmi

Kuorumi për zhvillimin e mbledhjes dhe marrjen e vendimit është në përputhje me përcaktimet ligjore dhe statutores si dhe nuk ka pengesa të përcaktuara në statut për marrjen e vendimit

Baza ligjore e këtij vendimi është ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Kodit Civil dhe Statuti i Shoqërisë.

**Sa më sipër dhe duke mbajtur në vëmendje vullnetin e ortakëve të shoqërisë,
Asambleja Vendosi:**

1. Të miratojë kalimin nëpërmjet shitjes, të 100% të kuotës së ortakut Erjon Kasmi që përfaqëson 50% të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, në favor të z. Redinal Muskaj.
2. Çmimi i shitjes të kuotës në pronësi të Shitësit, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë Fat & Proalb sh.p.k., dhe që i kalon blerësit z. Redinal Muskaj është në vlerën 160.000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro.
3. Pas kryerjes së shitblerjes sipas kontratës që do të dakordësohen palët struktura e ortakërisë së shoqërisë do të bëhet si vijon:
 - 3.1 **Redinal Muskaj 50%;**
 - 3.2 **Ervis Kau 50%.**
4. Marrëveshja për kalimin e 100% të kuotës së z. Erjon Kasmi që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë në favor të z. Redinal Muskaj, të bëhet me akt noterial dhe kushtet e mënyra e likuidimit të saj të pasqyrohen në kontratën përkatëse. Në kontratë të përcaktohet edhe momenti i hyrjes në fuqi të kalimit të pjesës së kuotës. Vetëm pas likuidimit të çmimit kontrata e shitblerjes do të bëhet e ekzekutueshme dhe do të regjistrohet në QKB me qëllim reflektimin e përqindjeve të reja të kuotave.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT E SHOQËRISË



ERVIS KAU

Ervis Kau

ERJON KASMI

Erjon Kasmi

CERTIFIED TRUE COPY
FROM THE ORIGINAL
B.A. Agjencia Bulevard